

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e praktikantit të kësaj gjykate Shpend Makasqi procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarës M. A. nga Prizreni, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/IL.nr.597-1/2016 të datës 08.06.2016 në shqyrtimin fillestar në praninë e prokurorit të shtetit Musli Gashi, të akuzuarës dhe përkthyeses së gjykatës Violeta Celina, me datë 05.06.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### **E akuzuara:**

**M. A.** nga i ati A. dhe e ëma A. e lindur F., e lindur me datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rruga ... nr..., ka të kryer shkollën fillore, amvise, e martuar, nënë e dy fëmijëve, me numër personal *numri personal...*, boshnjake, shtetase e Republikës së Kosovës, e gjendjes së varfër ekonomike.

### PËR SHKAK

Me datë 06.03.2016 rreth orës 17:00, në Prizren në rrugën ..., për shkak të mosmarrëveshjes paraprake, ia dëmton pasurinë e dëmtuarës B. A., me ç'rast e akuzuara shkon në shtëpinë e dëmtuarës në fjalosje e sipër ia dëmton katër xhama të derës së hyrjes dhe dy xhama të dritareve, me ç'rast i shkakton dëm material.

**Këso dore ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK.**

Gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 7, 85, 86, 73 dhe nenit 333 par.1 të KPK i shqipton:

### VËREJTJE GJYQSORE

E akuzuara **M. A.** pasi që ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK, veprën penale e cila është e rrezikshme dhe e dëmshme, e njëjta nëse sërish kryen vepra të tilla do të dënohet me dënim më të rëndë.

E dëmtuara B. (B.) A. nga Prizren rruga ... nr..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, pasi që e akuzuara është e gjendjes së varfër ekonomike – është amvise, është pa punë, prandaj lirohet

nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, sepse pagesa e tyre do të rrezikon gjendjen material të akuzuarës dhe anëtarëve të familjes.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.597-1/2016 të datës 08.06.2016, kundër të akuzuarës M. A. nga Prizreni, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, gjykata i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarës, e njëjta u deklarua se ka kuptuar aktakuzën, nuk e kundërshton provat materiale dhe e ndjen veten fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 06.03.2016 rreth orës 17:00, në Prizren rrugën ..., akuzuara M. A. për shkak të problemeve familjare me anëtarët e familjes, ka ardhur deri tek mosmarrëveshjet dhe konflikti me të dëmtuarën B. A., ia asgjëson, dëmton dhe e bënë të papërdorshme pasurinë e dëmtuarës në atë mënyrë që e dëmton dhe e thyen katër xhama të derës së hyrjes dhe dy xhama të dritareve, me ç'rast i shkakton dëm material

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga e akuzuarës për veprimet e përshkruar si në përshkrimin faktik të aktakuzës, me ç'rast edhe nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka prova të papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht, sepse mbështet në fakte që përmban aktakuza nga se e akuzuara prej fillimit të kësaj procedure ka qenë e njoftuar me të gjitha provat materiale të cilat i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës, të cilat prova asnjëherë nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarës është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe se në veprimet e saj formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, andaj gjykata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lidhur me kryesin dhe veprën e kryer i shqiptoi vërejtje gjyqësore, sepse konsideron se me qortim do të arrihet qëllimi i sanksioni, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i qortimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarës në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**P.nr.1451/2016 të datës 05.06.2017**

**Procesmbajtësi  
Shpend Makasqi**

**Gjyqtarja  
Teuta Krusha**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimet, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.